



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 5, Datë 06/02/2016

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 46, datë 16.05.2016, e Unionit Rom Korçë – Disutni Albania sh.d.a., ku pretendohet diskriminimi i Z. A.K., Kryetar i kësaj Shoqate, për shkak të “races”, “ngjyrës” dhe “etnisë”, nga ana e Z. M.H., pronar i Bar-Kafe “Singer Bar”, Korçë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

K O N S T A T O I :

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, në datën 13.05.2016, në orën 11:42, Z. A.K. së bashku me bashkëshorten e tij, M. K. dhe Z. Pëllumb Murati, sapo kanë hyrë në Bar-Kafe, Korçë janë ndeshur me një nga kamarierët e këtij bari, i cili i ka njoftuar që lokali do të mbyllej, ndërkohë që në ambientet e tij kishte shumë klientë të tjerë. Ankuesi pretendon se edhe Z. M.H., pronar i këtij lokali i ka thënë, se ishin duke pritur disa klientë të tjerë dhe tavolinat e lira do t’i mbante te rezervuara për ta. Duke qenë se lokali kishte ambiente të brendshme, të lira, ankuesi ka insistuar që ai dhe personat që e shoqëronin të pinin kafe në këto ambiente dhe pronari i lokalit ka pranuar. Në vijim, ankuesi pretendon se e ka ftuar Z. M. H. të flisnin dhe t’i tregonte arsyen e vërtetë, që fillimisht nuk i kishte pranuar në lokalin e tij, por pronari i lokalit nuk ka pranuar ta dëgjojë. Ankuesi sqaron se është i ndjerë i fyer dhe i trajtuar ndryshe, nga kjo sjellje e Z. M.H.. Në vijim, ankuesi ka pyetur kamarierin për emrin e tij. Kamarieri, i cili quhej V. D., ka njoftuar Z. M.H. për pyetjen e bërë nga ankuesi. Në atë moment, pronari i lokalit i është drejtuar ankuesit duke i thënë: *“Do e pini kafën dhe të ikni apo t’ju marr unë dhe t’ju nxjerr”*. Ankuesi pretendon

se këto fjalë u shoqëruan me urrejtje të paparë, aq sa përshtypja e tij ka qenë se përveç dhunës verbale, Z. M.H. ishte i gatshëm të përdorte edhe dhunën fizike ndaj tyre. Në vijim, ankuesi i është drejtuar Z. M.H., duke i thënë: *“Mos u shqetëso zotëri, unë ju kërkoja të vinit në tavolinën tonë për pak sekonda dhe ju nuk pranuat, por kjo është zgjedhja juaj”*. Më pas, Z. M.H. është larguar dhe u ul në një tavolinë tjetër në shoqërinë e disa personave të tjerë.

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

1. Pas analizimit të ankesës nr. 46, datë 16.05.2016, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
2. Mbështetur në nenin¹ 33, pika 7, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Z. M.H., pronar i Bar-Kafe “Singer Bar”, Korçë, me shkresën nr.534/1, datë 24.05.2016, ku kërkohej informacion, lidhur me çështjen e parashtruar nga ankuesi.

Në përgjigje të shkresës së mësipërme, Z. M.H. dërgoi shkresën nr. 534/2, datë 25.05.2016, ku sqarohet se në lokalit të tij, u shërbehet pa dallim të gjithë klientëve që e frekuentojnë atë. Shërbimi është i njëjtë për këdo, pavarësisht racës, ngjyrës dhe etnisë. Z. M.H. e mohon faktin, se në lokalit të tij është fyer apo ofenduar shtetasi Z. A.K., duke i konsideruar të pavërteta pretendimet e ankuesit. Ai thekson faktin, se Z. A.K. i është shërbyer njëllë si të gjithë klientëve të tjerë, në bazë të porosisë së vetë personit/klientit.

-Në vijim, Komisioneri iu drejtua sërish Z. M.H. me shkresën nr. 534/3, datë 01.06.2016, ku iu kërkuar të dërgohen prova që mbështesnin pretendimet e tij. Në këtë kontekst, atij iu kërkuar që, nëse brenda ambienteve të lokalit të tij kishte sistem survejimi nëpërmjet kamerave, të dërgohej pranë Komisionerit, sekuenca filmike e ngjarjes së pretenduar nga Z. A.K., në datën 13.05.2016, në orën 11:42, ose nëse dispononte prova të tjera, që dëshmonin në favorin e tij, të dërgoheshin brenda datës 07.06.2016, në adresë të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Z. M.H. nuk dërgoi përgjigje, as brenda afatit të caktuar nga Komisioneri dhe as në ditët në vijim.

¹Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: *“Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”*.

Mbështetur në provat e administruara nga të dy palët, rezultoi se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” përcaktohet një listë joshtrruese shkaqesh diskriminimi, ku “raca”, “ngjyra” dhe “etnia” janë tre shkaqe të parashikuara në listën e parashikuar nga ligjvënësi.

I. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe të pabarabartë të pretenduar nga ankuesi, Komisioneri gjykon se:

Pas shqyrtimit administrativ të ankesës, rezultoi se ankuesi ka depozituar pranë Komisionerit, në cilësinë e provës, vetëm një kopje të faturës tatimore të shërbimit të Singer Bar, Korçë, të datës 12.05.2016, ora 11:42. Ndërkohë që, në ankesën e tij, Z. A.K. pretendon se ngjarja ka ndodhur në datën 13.05.2016, ora 11.42. Në këtë kontekst, vihet re se ka mospërputhje të të dhënave të paraqitura nga ankuesi. Njëkohësisht, Komisioneri konstaton se pretendimet e tij nuk mbështeten në prova të tjera konkrete, të cilat mund të përdoren në favor të tij, gjatë procesit të shqyrtimit administrativ të ankesës. Ndërkohë që, Z. M.H., pronar i Bar-Kafe, Korçë kundërshton pretendimet e ankuesit si të pavërteta, duke theksuar faktin se në lokalitetin e tij u shërbehet një lloj të gjithë klientëve, pa asnjë dallim. Në këtë kontekst, rezulton se vihen përballë njëra-tjetrës, vetëm dëshmitë apo pretendimet e dy palëve, që marrin pjesë në këtë shqyrtim administrativ, pa patur prova të tjera konkrete, të cilat do të bënin të mundur vërtetimin e pretendimeve të ankuesit apo anasjellas.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se nuk disponon prova të mjaftueshme, për të vërtetuar nëse ankuesi është trajtuar ndryshe, apo nëse ai është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë, në kuptimin e nenit 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

II. Lidhur me shkaqet e diskriminimit të pretenduara nga ankuesi, Komisioneri gjykon se:

Nuk disponohen fakte dhe prova, që Z. A.K. të jetë trajtuar në mënyrë të ndryshme për shkak të racës, ngjyrës dhe etnisë, nga ana e Z. M.H., pronar i Bar-Singer, Korçë.

III. Lidhur me justifikimin e subjektit, ndaj të cilit drejtohet ankesa, Komisioneri gjykon se:

Z. M.H., pronar i Singer Bar, Korçë, në cilësinë e palës kundër së cilës drejtohet ankimi, nëpërmjet parashtrimeve të tij, mohon faktin e trajtimit të ndryshëm të Z. A.K., në krahasim me individë të tjerë, të cilët frekuentojnë Bar-Singer, Korçë. Gjatë analizimit të çështjes, rezultoi se

vihen përballë pretendimet e dy palëve në proces, pa patur prova të tjera të qënësishme, të cilat do të mund të ndihmonin procesin e të provuarit të këtyre pretendimeve.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 95, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 1, gërma b), e pika 2, si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 46, datë 16.05.2016, e Unionit Rom Korçë – Disutni Albania sh.d.a., në mungesë të provave për të vërtetuar pretendimet e parashtruara në këtë ankesë.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim sipas ligjit.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

Shkak – raca, ngjyra dhe etnia

Fusha – të mira dhe shërbime

Lloji i vendimit – pushim shqyrtimi për mungesë provash